



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 tetor 2016
Nr. ref.:RK990/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI181/14

Parashtrues

Lon Palushaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. PML-KZZ. nr. 170/2014, të 19 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Lon Palushaj, banor i Klinës. Ai përfaqësohet nga z. Ramë Gashi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës fillimisht e dorëzoi një kërkesë duke kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PN nr. 588/14, të 12 nëntorit 2014. Ai më pas e plotësoi kërkesën e tij fillestare me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. PML-KZZ. Nr. 170/2014, të 19 shkurtit 2015. Ky vendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 27 shkurt 2015. Ky Aktgjykim përfundimtar i Gjykatës Supreme tani është objekt i këtij Aktvendimi.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thirret në nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim në pritje të vendimit përfundimtar të Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 dhjetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
8. Më 21 janar 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës, në formën që e kishte në atë kohë iu dërgua Gjykatës së Apelit të Kosovës.
9. Më 27 janar 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi autorizimin për z. Ramë Gashi për ta përfaqësuar atë në procedurat në Gjykatë.
10. Më 5 qershor 2015, parashtruesi e plotësoi kërkesën e tij, duke përfshirë Aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës.
11. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues, për ta zëvendësuar gjyqtarin Kadri Kryeziu mandati i të cilit kishte skaduar.

12. Më 16 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi argumente shitesë që e plotësojnë kërkesën e tij.
13. Më 19 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi informata shitesë në mbështetje të kësaj kërkeje.
14. Më 16 gusht 2016, një kopje e kërkesës së fundit iu dërgua Gjykatës Supreme të Kosovës.
15. Më 13 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar kryesues në Kolegjin shqyrtues për ta zëvendësuar gjyqtarin Robert Carolan, ndërsa gjyqtaren Snezhana Botusharova anëtare të Kolegjit shqyrtues.
16. Më 14 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

17. Më 13 shtator 2006, një aksident i komunikacionit kishte ndodhur në komunën e Klinës, me ç'rast personi F. G. kishte pësuar lëndime trupore.
18. Më 12 shtator 2007, parashtruesi i kërkesës, në cilësi të avokatit të z. F. G., parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Klinë kundër Fondit Garantues të Kosovës. Me këtë padi pretendohet se F. G. kishte pësuar lëndime të konsiderueshme fizike si rezultat i aksidentit. Në padi më tej pretendohet se aksidenti ishte shkaktuar nga një vozitës, pa sigurim të automjeteve motorike.
19. Më 6 shkurt 2008, një certifikatë mjekësore ishte parashtruar në Gjykatën Komunale në Klinë nga mjeku B. B., për dokumentimin e lëndimeve që z. F. G. pretendohet t'i ketë pësuar në aksident.
20. Më 8 prill 2008, Gjykata Komunale në Klinë, kryesuar nga gjyqtari K. P., mbajti një seancë në të cilën ishte arritur një marrëveshje financiare ndërmjet parashtruesit dhe Fondit Garantues të Kosovës. Si rezultat i kësaj marrëveshjeje, një shumë të hollash është transferuar në llogarinë bankare që i përket parashtruesit të kërkesës.
21. Më 10 gusht 2010, parashtruesi i kërkesës, së bashku me gjyqtarin K. P., mjekun B. B. dhe përfaqësuesin e Fondit Garantues të Kosovës ishin akuzuar, *inter alia*, për veprën penale të krimit të organizuar në pajtim me nenin 274 par. 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK).
22. Më 24 maj 2012, me Aktgjykimin P. nr. 477/11, Gjykata e Qarkut në Pejë bëri ricilësimin e veprës penale dhe e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të mashtrimit në pajtim me nenin 261 (1) dhe (2) të KPK-së. Të bashkakuzuarit, gjyqtari K. P. dhe mjeku B. B., gjithashtu ishin dënuar për krime. Përfaqësuesi i Fondit Garantues të Kosovës ishte liruar.
23. Parashtruesi i kërkesës u dënua me 3 (tri) vite burgim dhe *“në përputhje me nenin 54 paragrafin 1 dhe 2 pikën 4 dhe nenin 57 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së, si dhe me një dënim plotësues me ndalim të ushtrimit të profesionit, i aktiviteteve ose detyrës për një periudhë tre (3) vjeçare duke filluar nga dita*

kur ky aktgjykim behet i formës së prerë, me kusht që periudha kohore e kaluar në burg nuk përfshihet në kohëzgjatjen e këtij dënimi plotësues”.

24. Më 11 korrik 2012, Prokurori Special i Kosovës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi të Gjykatës së Qarkut në Pejë. Kjo ankesë kishte të bënte vetëm me lirimin e përfaqësuesit të Fondit Garantues të Kosovës.
25. Më 12 korrik 2012, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër dënimit të tij, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesat, janë parashtruar edhe nga të bashkëpandehurit e tjerë.
26. Më 25 prill 2013, Gjykata e Apelit, si gjykatë që ka juridiksion në bazë të Ligjit të ri për gjykatat, me Aktgjykimin PAKR nr. 1122/2012, vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 24 majit 2012 (Aktgjykimi P. nr. 477/11) në lidhje me dënimin e parashtruesit të kërkesës.
27. Më 26 dhjetor 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se ai thjesht kishte përfaqësuar vetëm palën e dëmtuar, z. F. G., megjithëse pa një autorizim, por se ai kishte qenë i mashtruar nga gjyqtari K. P., me të cilin ai kishte shërbyer stazhin e tij të praktikantit si avokat, se ai nuk kishte pasur asnjë përfitim material dhe se dënimi ishte i tepërt për veprën të parë. Parashtruesi i kërkesës pohon se ai duhej të kishte përfituar nga parimi *in dubio pro reo*.
28. Më 6 janar 2014, 25 shkurt 2014, 18 qershor 2014 dhe 10 korrik 2014, në bazë të rigjyimit dhe dënimit të përfaqësuesit të Fondit Garantues të Kosovës, parashtruesi i kërkesës ofroi argument shtesë në Gjykatën Supreme duke pretenduar se i bashkëpandehuri gjyqtari K. P. kishte ndryshuar dëshminë e tij fillestare dhe se për këtë arsye, parashtruesi i kërkesës duhet të përfitojë një rigjykim. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkoi që të rihapet procedurë penale kundër tij, dhe që të arrihet shtyrja e ekzekutimit të dënimit. Këto përpjekje nuk ishin të suksesshme.
29. Më 19 shkurt 2015, me Aktgjykimin nr. PML-KZZ. nr. 170/2014, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar. Në të njëjtin aktgjykim, Gjykata Supreme konstatoi se dënimi kundër gjyqtarit K. P. duhet të ndryshohet dhe deklaroi se ri-cilësimi i veprës penale në lidhje me mjekun B. B. ishte i paligjshëm, dhe se mjeku B. B. lirohet.
30. Në lidhje me kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme deklaroi se:

“Gjykata Supreme është e mendimit se edhe elementet objektive e edhe ato subjektive të veprës penale Mashtrim janë vërtetuar në aktgjykimin e shkallës së parë dhe janë përshkruar në hollësi në dispozitiv. Dispozitivi është i qartë dhe i kuptueshëm.

Duke përmendur qëllimin për të përfituar dobi pasurore të kundërligjshme për veten dhe të bashkëpandehurin K.P., Gjykata e Qarkut ka përshkruar mens rea e cila kërkohet me nenin 261 paragrafin 1 të KPK-

së. Detajet e planit i cili është përgatitur së bashku nga të pandehurit janë përshkruar në dispozitiv. Plani konsistonte në paraqitjen e kërkesës për kompensim kundër Fondit Garantues të Kosovës pranë gjykatës në emër të F. G. pa njohurinë e personit, zmadhimin e lëndimeve të pësuar nga F. G. që si rezultat kanë përfituar dobi pasurore. Elementet objektive konsistojnë në realizimin e planit të përshkruar me të pandehurit duke e 'përfaqësuar' gjoja palën e dëmtuar F. G. pa autorizimin apo njohurinë e tij në procedurën gjyqësore, duke pranuar shumën e kompensimit, përfshirë shpenzimet e procedurës gjyqësore si dhe kompensimin e tij si avokat për 'përfaqësimin' e paditësit, të paguar nga Fondi Garantues i Kosovës dhe duke ia dhënë K. P. shumën prej 16,000 euro".

31. Në lidhje me aktakuzën e të bashkakuzuarit, mjeku B. B., Gjykata Supreme arsyetoi vendimin e saj për ta liruar atë, si më poshtë:

"Aktakuza ngarkon B.B. vetëm për veprim në kuadër të grupit të organizuar kriminal, duke ndihmuar K. P. në shpërdorimin e pozitës së tij zyrtare. Aktakuza në lidhje me të pandehurin B.B. nuk përshkruan elementet objektive esenciale të veprës penale Mashtrim, si aktin e mashtrimit të personit tjetër apo mbajtjen e personit në mashtrim, mjetet e përfaqësimit të rremë apo fshehjen e fakteve dhe shtytjen e viktimës që të veprojnë në atë mënyrë apo të abstenojnë nga veprimi në dëm të pronës së tij apo saj apo pronës së personit tjetër, as nuk përmend asnjë element subjektiv korrespondues - dashjen për kryerjen e këtyre veprimeve - të kërkuar me nenin 261 paragrafin 1 të KPK-së. Gjykata e Qarkut sipas nenit 286 paragrafit 2 të KPPK-së nuk ka qenë e obliguar me cilësimin juridik të aktit në aktakuzë. Sidoqoftë, ri-cilësimi të cilin trupi gjykues ka qenë i lejuar që ta bëjë është dashur të korrespondojë me aktin, siç përcaktohet me nenin 305 paragrafin 1 nën-paragrafin 4 të KPPK-së, i cili në fakt është objekt i akuzës. Në këtë lëndë, me ri-cilësimin e veprës penale si Mashtrim sipas nenit 261 paragrafit 1 të KPK-së, gjykata ka tejkaluar aktakuzën. Gjykata e Apelit ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë në lidhje me këtë dhe nuk e ka korrigjuar shkeljen".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thirret në nenin 6.1 të KEDNJ-së.
33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ishte trajtuar në mënyrë të barabartë me të bashkakuzuarin, mjekun B. B., sepse i bashkakuzuari është liruar, ndërsa parashtruesi i kërkesës është dënuar në bazë të të njëjtit ri-cilësim të veprës penale. Parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i ishte mohuar mundësia për të paraqitur argumentet në lidhje me ri-cilësimin e veprës penale nga krimi i organizuar në mashtrim, në kundërshtim me të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe për të paraqitur mbrojtjen e tij.
34. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të konstatojë se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese dhe ta urdhërojnë një rigjykim ose,

përndryshe, ta lirojë atë. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ka kërkuar nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme.

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”
[...]

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

37. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili thotë se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

38. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, i cili parasheh se:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

39. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit lidhen kryesisht me mënyrën në të cilën gjykatat e rregullta e trajtuan aktakuzën kundër tij. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta duhet t'i kenë dhënë atij mundësinë për të paraqitur argumente në lidhje me ri-cilësimin e veprës penale të mashtrimit. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat nuk kanë shqyrtuar në mënyrë adekuate dëshminë e paraqitur nga të bashkë-akuzuarit. Parashtruesi pretendon se ai duhet të ketë përfituar nga parimi *in dubio pro reo*.

40. Gjykata rikujton nenin 30, paragrafin 3, të Kushtetutës, i cili thotë se:

“Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

[...]

3. të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

[...]”

41. Gjykata rikujton nenin 31 të Kushtetutës, i cili, *inter alia*, parasheh se:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

[...]”

42. Gjykata gjithashtu rikujton nenin 6 të KEDNJ-së, i cili parasheh, *inter alia*, se:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile

[...].

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

[...]

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

[...]"

43. Gjykata rikujton se neni 30 dhe 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, që ka të bëjë me të drejtën për gjykim të drejtë penal, në thelb merret me faktin nëse parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta argumentojë rastin e tij dhe ta kontestojë interpretimin e provave. Përveç kësaj, nuk është në juridiksionin e Gjykatës që ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta, dhe si rregull i përgjithshëm, është roli i këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat para tyre. Roli i Gjykatës është që të përcaktojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, kanë qenë të drejta, duke përfshirë mënyrën se si janë interpretuar provat (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, para. 34).
44. Gjykata nuk mund të zëvendësojë gjykimin e saj me atë të Gjykatës së Qarkut në lidhje me atë se çfarë dëshmuar apo nuk dëshmuar provat në rastin e parashtruesit të kërkesës. Për të gjetur se ka pasur shkelje kushtetuese të së drejtës për gjykim të drejtë në këtë rast në lidhje me mjaftueshmërinë e provave, kjo Gjykatë do të duhej të gjejë se jo vetëm arsyetimi i Gjykatës së Qarkut, por edhe arsyetimi i Gjykatës së Apelit, si dhe ai i Gjykatës Supreme në lidhje me interpretimin e provave dhe cilësimin e veprës penale, kishte aq të meta sa që, në të vërtetë, aktgjykimet e gjykatave të rregullta nuk ishin të arsyetuara.
45. Gjykata rikujton se nëse një aktgjykim për dënim nuk është i arsyetuar, ekziston supozimi se i pandehuri nuk ka pasur gjykim të drejtë. (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese Aktvendim i 2 qershorit 2016 nr. 01/15, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit nr. PML. KZZ 157/2014 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 2 tetorit 2014, para. 39*).
46. Gjykata vlerëson se për të konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur gjykim të drejtë në pajtim me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës, ose nenin 6 të KEDNJ-së, kjo Gjykatë do të duhej të konstatojë se vendimi dhe aktgjyrimi i Gjykatës Supreme dhe të gjykatave të ulëta nuk ishin arsyetuar.
47. Gjykata nuk mund ta bëjë atë konstatim në këtë rast. Në të vërtetë, Gjykata e Qarkut, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë bërë gjetjet e detajuara faktike në lidhje me interpretimin e provave dhe cilësimin që duhet të jepet për veprën penale për ta mbështetur vendimin se parashtruesi i kërkesës është dëshmuar fajtor përtej dyshimit të bazuar për krimin e kryer të mashtrimit. Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme të cituar në paragrafin 28.
48. Për këtë arsye, Gjykata konkludon se pretendimet për shkelje të së drejtës për të paraqitur mbrojtje dhe të së drejtës për gjykim të drejtë duhet të refuzohen si të papranueshme.
49. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se ai nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me të bashkakuzuarin, mjekun B.B., sepse në

rastin e mjekut nuk është pranuar ri-cilësimi i veprës penale, ndërsa në rastin e parashtruesit të kërkesës ky ri-cilësim ishte pranuar.

50. Gjykata vëren se Gjykata Supreme arsyetoi vendimin e saj për ri-cilësimin e veprës penale në lidhje me mjekun në bazë të mungesës së elementeve të caktuara të veprës penale të mashtrimit, ndërsa Gjykata Supreme gjeti se këto elemente ishin të pranishme në rastin e parashtruesit të kërkesës. Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme të cituar në paragrafin 29.
51. Gjykata përsërit se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga Gjykata Supreme. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të përcaktojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre kanë qenë të drejta, duke përfshirë mënyrën se si janë marrë provat (shih, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
52. Në rastin konkret, Gjykata nuk ka gjetur se procedurat përkatëse në gjykatat e rregullta ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës i 30 qershorit 2009).
53. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë si dhe pse me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij, siç mbrohen me Kushtetutë.
54. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

Kërkesa për vendosje të masës së përkohshme

55. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht ta pezullojë përmbarimin e vendimit për vuajtjen e dënimit deri sa Gjykata Supreme të nxjerrë vendim lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.
56. Gjykata vëren se pas kësaj kërkesë të 15 dhjetorit 2014 për masë të përkohshme, më 19 shkurt 2015, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin e saj lidhur me kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Si e tillë, që nga ajo ditë, kërkesa për masë të përkohshme kishte humbur objektin e saj.
57. Siç u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet, si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi